

URDHËR
Nr. 164, datë 26.7.2024

PËR PËRCAKTIMIN E ORGANIT TË NDËRMJETËM PËR MENAXHIMIN E POLITIKAVE (ONMP), TË DREJTUESIT DHE PËRGJEGJËSISË SË NËNSHKRIMIT PËR ZBATIMIN PËRMES MENAXHIMIT INDIREKT TË PROGRAMIT VJETOR IPA III NË LIDHJE ME AKTIVITETIN PËR HEKURUDHAT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III), ratifikuar me ligjin nr. 65/2022, të nenit 28, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në përputhje me vendimin nr. 540, datë 20.9.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësi dhe marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve e strukturave për menaxhimin indirekt të asistencës financiare të Bashkimit Evropian nën Instrumentin për Asistencën e Paraanëtarësimit 2021–2027 (IPA III)”,

URDHËROJ:

1. Sektori i Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Transportit Hekurudhor, në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Transportit dhe Infrastrukturës, në Drejtorinë e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, caktohet për të përmbushur përgjegjësitë e Organit të Ndërmjetëm për Menaxhimin e Politikave (ONMP), për zbatimin përmes menaxhimit indirekt të veprimit të BE-Së për Shqipërinë për vitin 2022, në lidhje me aktivitetin për hekurudhat, të financuar nga BE-ja në kuadër të IPA III, në përputhje me parashikimet e FFPA-Së dhe kuadrin ligjor për IPA III.

2. Znj. Zana Joca, si drejtuese e Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Transportit Hekurudhor, drejton ONMP-në dhe autorizohet të nënshkruajë dokumentet e mëposhtme:

a) marrëveshje mbi bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet Koordinatorit Kombëtar të IPA-së, Zyrtarit Kombëtar të Autorizimit, Autoritetit Menaxhues, organeve të ndërmjetme për menaxhimin e politikave dhe Organit të Ndërmjetëm për Menaxhimin Financiar për zbatimin përmes menaxhimit indirekt të veprimit të “BE për Shqipërinë” për vitin 2022, në lidhje me aktivitetin për hekurudhat, të financuar nga BE-ja në kuadër të IPA III;

b) rregulloret dhe udhëzuesit proceduriale të IPA III, për organet e ndërmjetme për menaxhimin e politikave;

c) çdo raport, dokument apo komunikim tjetër lidhur me zbatimin e veprimit “BE për Shqipërinë” të mbajtur me Koordinatorin Kombëtar të IPA-së, Zyrtarin Kombëtar Autorizues, Autoritetin Menaxhues, Autoritetin Auditues, organit kontabël, Zyrës Mbështetëse të ZKA-së, organin e ndërmjetëm për menaxhimin financiar dhe çdo komunikim tjetër të lidhur me përgjegjësitë funksionale të ONMP-ve të parashikuara në FFPA dhe VKM nr. 540, datë 20.9.2023.

3. Urdhri nr. 45, datë 28.2.2024, “Për përcaktimin e Organit të Ndërmjetëm për Menaxhimin e Politikave (ONMP), të drejtuesit dhe përgjegjësisë së nënshkrimit për zbatimin përmes menaxhimit indirekt të programit vjetor IPA III”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet znj. Zana Joca dhe Sektori i Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Transportit Hekurudhor, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku